

# Qendra Rinore Multifunktionale

## Bashkia Lushnje



Si institucion i qeverisjes vendore, misioni i bashkisë Lushnje është t'i shërbejë interesave më të larta të komunitetit, duke garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre sociale. Bashkia Lushnje gjithashtu përpiqet të sigurojë barazi sociale, të drejta të barabarta dhe mbrojtjen mjedisore. Më e rëndësishmja, si organ publik, bashkia Lushnje i kushton shumë rëndësi rinisë, interesave të tyre, arsimimit, zhvillimit profesional dhe çdo aspekti tjetër që lidhet me ta.

Rinia është parë gjithmonë si një forcë lëvizëse e shoqërisë sonë dhe ne gjithmonë jemi përpjekur t'i nxisim ata të arrijnë qëllimet, duke mos dyshuar kurrë në potencialin e tyre. Pandemia e COVID-19 pati shumë efekte negative psikologjike dhe emocionale veçanërisht tek të rinjtë. Ajo ndikoi në procesin mësimor të të rinjve po aq sa në procesin e të mësuarit të fëmijëve. Bashkia Lushnje vendosi të punojë për përmirësimin e këtij aspekti duke krijuar infrastrukturë të re dhe duke ndërtuar kapacitete rinore, me fokus të veçantë tek të rinjtë që jetojnë në zonat rurale.

Qendra Rinore Multifunktionale është një shërbim i ri i ofruar nga Bashkia Lushnje për të fuqizuar të rinjtë në qytetin e Lushnjës dhe çdo Njësi Administrative në zonat rurale. Qëllimi kryesor i krijimit të këtij shërbimi është përmirësimi i kushteve socio-ekonomike të të rinjve nëpërmjet ofrimit të infrastrukturës publike dhe cilësisë së aksesit në shërbime. Përfituesit kryesorë të këtyre shërbimeve janë të rinjtë e Lushnjës (15-29 vjeç), komuniteti në tërësi, organizatat rinore, institucionet vendore dhe çdo aktor e grup interesi vendor/kombëtar/ndërkombëtar.



Në Qendrën Rinore Multifunkionale ofrohen shërbime falas duke përfshirë:

katër (4) Klube Rinore:


- Art dhe Kulturë
- Sport
- Mjedis
- Integrim

tre (3) kurse falas:

- Pikturë,
- Kërcim,
- Muzikë.

si dhe aktivitete të tjera të larmishme rinore.

Qendra u krijua falë mbështetjes së skemës së granteve EU4Municipalities dhe aktualisht janë duke u zhvilluar shumë aktivitete rinore. Bazuar në rezultatet e pritshme të projektit D.R.E.A.M. lidhur me lehtësimin e procesit mësimor si dhe kërkesat e të rinjve, Bashkia Lushnje krijoi një hapësirë të dedikuar IT për fëmijët në Qendrën Kulturore të Fëmijëve por gjithashtu zgjeruam grupin e synuar duke krijuar një hapësirë të dedikuar IT për të rinjtë në Qendrën Rinore Multifunkionale. Në këto mjedise të rinjtë mund të kenë akses në pajisje teknologjike si dhe lidhje interneti për të përmirësuar procesin e të nxënit duke kërkuar në internet dhe duke përdorur platforma, faqe interneti, rrjete të ndryshme falas. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në zona të largëta rurale pa akses në internet. Stafi i bashkisë Lushnje, organizoi takime në çdo njësi administrative për të ftuar të rinjtë që t'i bashkohen dhe përfitojnë nga shërbimi dhe shumë prej tyre tashmë janë bashkuar.



Nëse dëshironi të mësoni më shumë rreth aktiviteteve dhe shërbimeve rinore që ofrohen në qendër dhe jeni duke kërkuar disa mënyra për ngritjen e kapaciteteve rinore dhe sigurimin e infrastrukturës përkatëse për të mundësuar fuqizimin e tyre, shikoni videon: <https://www.youtube.com/watch?v=VP-HS-wIOLE&t=25s>

Gjithashtu mund të shikoni faqen e internetit: <https://bashkialushnje.gov.al/qendra-rinore-multifunkionale/> për më shumë detaje dhe informacion, ose dërgoni pyetjet tuaja në adresën e email: [bashkia\\_lushnja@yahoo.com](mailto:bashkia_lushnja@yahoo.com) or [belisa.haxhiu@yahoo.cm](mailto:belisa.haxhiu@yahoo.cm) (Person kontakti për projektin).

### Aktivite rinore:

















